



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM  
Nr.07, Datë 15.01.2021

“MBI  
MIRATIMIN E FORMULARIT TE PËRDITËSUAR TË ANKESAVE TË  
KLIENTËVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të nenit 16, nenit 77, pika 9, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15 germa ç, dh dhe e të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 15.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr.142/19 prot, datë,24.12.2020, për gatitur nga Drejtoria Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standateve mbi Miratimin e formularit të përditesuar të ankesave.

**Konstatoi se:**

- Objekti i punës së Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standarteve ndër të tjera konsiston dhe në trajtimin dhe zgjidhjen e të gjitha ankesave dhe konflikteve direkte që lindin nga marrëdhëniet midis Furnizuesit të energjisë elektrike apo gazit natyror dhe klientëve, si dhe midis të licencuarve, duke pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të klientëve fundorë dhe mbrojtjen e interesave të tyre në tërësinë nga abuzimet në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.
- Formulari i përditësuar i ankesave është riformatuar për lehtësi plotësimi nga ana e klientëve të energjisë si dhe plotësuar me të dhëna që lehtësojnë procesin e regjistrimit të ankesave në kushtet e punës së kombinuar të administratës, në zbatim të vendimit nr. 867, datë 11.11.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar.
- Në përmbajtje të formularit janë vendosur gjithashtu edhe parashikimet e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale duke i bërë me dije çdo klienti që nënshkruan këtë formular qëllimin për të cilin autorizon përpunimin e të dhënave të vëna në dispozicion.
- Në përmbajtje të formularit janë plotësuar parashikime për përzgjedhjen e modaliteteve të adresimit të ankesës në korrespondencë zyrtare apo nëpërmjet komunikimit

elektronik, përcaktimin e statusit të ankuesit në klient të energjisë elektrike apo gazit natyror, etj

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Miratimin e Formularit të ankesave klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror. (Bashkëlidhur formulari i ankesave).
2. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standarteve me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë